



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 275/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha Kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes të heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 09.06.2014, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se gjatë ditës të Zgjedhjeve me datën 08.06.2014 rreth orës 10:35 Valizake Thaçi Celina aktiviste e LVV-së ka raportuar se në numrin e saj të telefonit i ka ardhur një sms me përmbajtje për përkrahjen e subjektit politik AAK, për ta inkurajuar votimin e AAK-së për kandidatin Hasan Cacaj. Andaj me këtë veprim është bërë shkelje e Neni 8.1 pika c), të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi të sms të dërguara në numrin personal të Valizake Thaçi Celina.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-i me datë 10.06.2014 e informoi subjektin politik AAK, për ankesën që është bërë kundër këtij subjekti politik nga LVV, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 11.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK në të cilën deklaroi se në bazë të provave të paraqitura në këtë ankesë është bërë abuzim nga ana e LVV-së, esemesi i printuar nga LVV nuk tregon datën, kur është dërguar as kur është pranuar sms. Po ashtu lusim PZAP-in që të marrë për bazë veprimet e AAK-së si dhe Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së drejtuar të gjitha strukturave të AAK-së për respektimin e Rregullave dhe Ligjit për Zgjedhjet si dhe Kërkesën drejtuar Shefave të Shtabeve Zgjedhore dhe Kandidatëve për Respektimin e Kodit Zgjedhor të datës 30.05.2014.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Në bazë të provave të ofruara, nuk mund të vërtetohet data dhe ora e dërgimit të sms për të cilën pretendohet në ankesën e LVV-së, se është dërguar në ditën e Zgjedhjeve me 08 Qershor. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në provë relevante, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në Nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: *”PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet “* lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 275/2014 më datën 12.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Muhamed Rexha



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*